



RAPORTI VJETOR 2025



*Një demokraci më e fortë kërkon një shoqëri civile të fortë.
Së bashku e bëjmë këtë të mundur.*

Ju jemi mirënjohës për mbështetjen tuaj:





PËRMBAJTJA

5	Letër nga Udhëheqsija
7	Ndikimi në numra
9	Viti 2025 në rishikim
10	1. Forcimi i Bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri
12	2. Besimi në Epokën Digjitale: Mbrojtja e të Dhënave personale dhe Siguria Kibernetike
14	3. Demokracia që Fillon në Komunitet: Fuqizimi i Pjesëmarrjes Qytetare në Nivel Lokal
16	4. Fuqizimi i Rrjetit dhe Funksionimi i Sekretariatit të Platforma Civikos
19	Storie Suksesi
20	Ngjarjet dhe Publikimet



Takimin konsultativ me organizata të shoqërisë civile për prezantimin e Draft Strategjisë për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile 2025-2030. | Prill 2025

Letër nga Udhëheqësija



Nermin Mahmut
Kryetare e Bordit
Platforma Civikos



Dardan Kryeziu
Drejtor Ekzekutiv
Platforma Civikos

Viti 2025 ishte një vit reflektimi dhe përshtatjeje për shoqërinë civile në Kosovë. Ndryshimet në sektorin global të zhvillimit, reduktimi i disa burimeve tradicionale të financimit dhe një periudhë e pasigurisë politike krijuan një mjedis më sfidues për organizatat e shoqërisë civile. Në këtë kontekst, kapitulli i këtij viti ishte qëndrueshmëria e sektorit dhe nevoja për partneritete më të forta ndërmjet shoqërisë civile, institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Pavarësisht këtyre sfidave, shoqëria civile në Kosovë vazhdoi të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e interesit publik, në nxitjen e transparencës dhe në krijimin e hapësirave për pjesëmarrje qytetare. Organizatat e shoqërisë civile kontribuan në diskutime të rëndësishme për politikat publike, në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe në avancimin e standardeve të qeverisjes demokratike.

Për Platforma Civikos, ky vit ishte gjithashtu një moment i rëndësishëm i konsolidimit institucional. Platforma Civikos mbajti Kuvendin e Anëtarëve, ku u miratuan raportet vjetore dhe u zgjodh Bordi i ri i organizatës, ndërsa më pas u emërua edhe Drejtori i ri Ekzekutiv. Këto zhvillime forcuan qeverisjen e brendshme të platformës dhe krijuan bazën për fazën e ardhshme të zhvillimit të saj. Në të njëjtën kohë, përmes bashkëpunimit me organizatat anëtare, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë, Platforma Civikos vazhdoi të shërbejë si hapësirë dialogu dhe koordinimi për sektorin e shoqërisë civile.

Zhvillimet e fundit kanë treguar gjithashtu se sektori duhet të vazhdojë të përshtatet me një realitet të ri. Rritja e rëndësisë së qeverisjes digjitale, nevoja për transparencë më të madhe në nivel lokal dhe kërkesa për pjesëmarrje më të gjerë qytetare po e formësojnë gjithnjë e më shumë mënyrën se si organizatat e shoqërisë civile angazhohen në proceset publike.

Ne jemi thellësisht mirënjohës për organizatat anëtare të Platforma Civikos, partnerët institucionalë dhe donatorët ndërkombëtarë që vazhdojnë të mbështesin zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Përkushtimi dhe bashkëpunimi i tyre janë thelbësorë për ruajtjen e një sektori të pavarur, aktiv dhe me ndikim.

Duke parë përpara, tre prioritete do të udhëheqin punën tonë në vitin 2026:

- forcimi i dialogut institucional dhe i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike;
- mbështetja e pjesëmarrjes qytetare dhe e demokracisë lokale;
- ndërtimi i një sektori më të qëndrueshëm dhe më të aftë për t'u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e zhvillimit.

Shoqëria civile mbetet një nga shtyllat kryesore të një demokracie funksionale. Në një kohë ndryshimesh dhe sfidash, është bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve, institucioneve dhe organizatave që e bën të mundur këtë.



Platforma CiviKos është një iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e ndërtuar për të krijuar dhe promovuar një mjedis të favorshëm për bashkëpunimin e sektorit formal të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës.

Ndikimi në numra



321 organizata

nga e gjithë Kosova të përfaqësuara në rrjetin e Platformës Civikos



7 rajone të Kosovës

ku u zhvilluan aktivitete dhe sesione informuese



42 institucione publike

të përfshira në programe, trajnime dhe dialog institucional



112 profesionistë

të trajnuar dhe certifikuar për mbrojtjen e të dhënave personale



16 trajnerë

të certifikuar për privatësi dhe siguri digjitale



70+ pjesëmarrës

në sesionet rajonale dhe konferencën kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale



2 punëtori kryesore me 62 pjesëmarrës

për demokracinë lokale dhe Këshillat Lokale



1 bazë kombëtare e të dhënave

për përfaqësuesit e Këshillave Lokale



71 buletine informative

me mundësi dhe njoftime specifike për organizatat e shoqërisë civile



1 Kuvend i Anëtarëve

dhe Bord i ri drejtues i zgjedhur për Civikos



134,368 shikime dhe 6,253 ndërveprime

të përmbajtjes nga audienca në rrjetet sociale



Fokus Grupi i organizatave të shoqërisë civile mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në sektorin e OJQ-ve. | Prill 2025

Viti 2025 në rishikim

- 10 1. Forcimi i Bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri**
Bashkëpunimi me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit
- 12 2. Besimi në Epokën Digjitale: Mbrojtja e të Dhënave personale dhe Siguria Kibernetike**
Bashkëpunimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP)
- 14 3. Demokracia që Fillon në Komunitet: Fuqizimi i Pjesëmarrjes Qytetare në Nivel Lokal**
Bashkëpunimi me Këshillat Lokale, Organizatat Lokale dhe Komunitat
- 16 4. Fuqizimi i Rrjetit dhe Funksionimi i Sekretariatit të Platforma Civikos**
Puna e Sekretariatit dhe Qeverisja e Brendshme

1. Forcimi i Bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri

Bashkëpunimi me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit

Gjatë vitit 2025, Platforma Civikos ka vazhduar me koordinimin e punës ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, duke mbështetur mekanizmat institucionalë të bashkëpunimit dhe duke lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes.

Në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, Platforma Civikos kontribuoi në procesin e hartimit të Strategjisë së re për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile 2026–2030, duke mbështetur gjithashtu punën e grupit punues të themeluar për hartimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.



Takim për forcimin e bashkëpunimit Qeveri – Shoqëri Civile. | Korrik 2025

ARRITJET KRYESORE

- U koordinua puna e grupeve tematike të shoqërisë civile për zbatimin e Strategjisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.
- U organizua punëtori me organizata të shoqërisë civile për të konsultuar Strategjinë e re
- U zhvilluan takime me ministri dhe institucione qeveritare për të avancuar zbatimin e Strategjisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.
- U organizuan takime të grupit strategjik ndërinstitucional për koordinimin e zbatimit të strategjisë.
- Platforma CiviKos, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe me mbështetjen e BE/TACSO, organizoi një takim konsultativ ku u prezantua Draft Strategjia për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile 2025–2030, duke theksuar objektivat dhe rëndësinë e forcimit të dialogut, transparencës dhe përfshirjes qytetare.
- U mbështet procesi i hartimit të Strategjisë së re për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2026–2030 përmes organizimit të takimeve të grupit punues dhe konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile.
- Platforma CiviKos së bashku me ZQM organizuan takim me përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve publike për forcimin e bashkëpunimit Qeveri–Shoqëri Civile, ku u diskutua ndikimi i ndaljes së fondeve të USAID dhe nevoja për rritjen e financimit publik për OSHC-të.
- Platforma CiviKos hartoi [Analizën ligjore për Bashkëfinancimin e projekteve të Be-së](#).

PUNA NË VAZHDIM

- Mbështetja e zbatimit të Strategjisë së re për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile 2026–2030.
- Forcimi i rolit të Këshillit për Bashkëpunim Qeveri – Shoqëri Civile si mekanizëm kryesor i dialogut institucional.
- Zgjerimi i konsultimeve dhe përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile nga të gjitha rajonet e Kosovës në proces të hartimit të Strategjisë së re.



“Gjatë vitit 2025, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka zhvilluar bashkëpunim të ngushtë me Platforma CiviKos, si rrjeti më i madh i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Ky partneritet ka qenë veçanërisht i rëndësishëm në procesin e hartimit të Strategjisë së re Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, ku Platforma CiviKos ka kontribuar në mobilizimin e organizatave dhe në sjelljen e rekomandimeve të tyre në procesin e konsultimeve. ZQM vlerëson Platforma CiviKos si një partner të besueshëm në forcimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile në Kosovë.”

Habit Hajredini,
Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

2. Besimi në Epokën Digjitale: Mbrojtja e të Dhënave personale dhe Siguria Kibernetike

Bashkëpunimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP)

Me mbështetjen e Ambasadës së Holandës në Kosovë përmes programit MATRA, Platforma Civikos dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) kanë bashkëpunuar për të ngritur kapacitetet në siguri kibernetike dhe mbrojtje të të dhënave personale në institucionet publike lokale dhe qendrore, duke e vendosur privatësinë dhe sigurinë digjitale si standard praktik në institucione dhe në shoqërinë civile përmes partneriteteve, trajnimeve dhe mjeteve praktike. Në një kohë kur shërbimet publike dhe puna e OShC-ve varen gjithnjë e më shumë nga platformat digjitale, ky bashkëpunim ka kontribuar në rritjen e besimit publik përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale, krijimit të udhëzimeve praktike dhe zgjerimit të diskutimit për privatësinë edhe në nivel rajonal.



Konferenca përmbyllëse e projektit “Fuqizimi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Sigurisë Kibernetike në të gjitha sektorët në Kosovë” | Shtator2025

ARRITJET KRYESORE

- U organizua trajnim ToT, ku u certifikuan 16 trajnerë për privatësi dhe siguri digjitale.
- U realizuan trajnimet e avancuara për DPO, me 112 pjesëmarrës, ku 100 u certifikuan.
- U forcua bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e standardeve të privatësisë.
- U zhvillua format i standardizuar i raportimit të pajtueshmërisë me GDPR, me 44 fusha raportimi.
- U mbajtën sesione informuese në 7 rajone për qytetarë, OShC, biznes dhe institucione publike dhe një konferencë përmbyllëse kombëtare me mbi 70 pjesëmarrës.
- U krijua program i punës praktike në AIP për deri në 5 të rinj profesionistë.
- U zhvillua fushatë informuese gjatë gjithë vitit me infografika dhe video për mbrojtjen e të dhënave personale.
- U hartua [Udhëzuesi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për organizatat e shoqërisë civile](#), me pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile dhe AIP.

PUNA NË VAZHDIM

- Vazhdimi i bashkëpunimit me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP) për forcimin e kapaciteteve institucionale në mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë kibernetike.
- Promovimi dhe shpërndarja e Udhëzuesit për OShC-te tek organizatat e shoqërisë civile për të mbështetur zbatimin praktik të standardeve të privatësisë.
- Zgjerimi i trajnimeve dhe programeve të ngritjes së kapaciteteve edhe në sektorë të tjerë të institucioneve publike, përfshirë nivelin lokal, qendror dhe institucionet e pavarura.



“Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe Platformës Civikos është zhvilluar si një partneritet i ndërsjellë i orientuar drejt një qëllimi të përbashkët: avancimit të standardeve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimit të transparencës institucionale në Republikën e Kosovës.

Përmes këtij bashkëpunimi janë fuqizuar kapacitetet profesionale dhe është kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik, duke mbështetur zhvillimin e një qasjeje më të strukturuar dhe efektive në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike. Ky angazhim i përbashkët ka ndihmuar në konsolidimin e praktikave institucionale dhe në promovimin e një kulture më të gjerë të respektimit të privatësisë dhe transparencës në shoqëri.”

Krenare Sogojeva Dërmaku,
Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi

3. Demokracia që Fillon në Komunitet: Fuqizimi i Pjesëmarrjes Qytetare në Nivel Lokal

Bashkëpunimi me Këshillat Lokale, Organizatat Lokale dhe Komunitat

Viti 2025 u karakterizua nga një periudhë e zgjatur paqëndrueshmërie politike dhe institucionale në Kosovë, me zgjedhje parlamentare dhe lokale, vështirësi në formimin e qeverisë dhe kufizime në vendimmarrjen administrative. Në këtë kontekst, mekanizmat e demokracisë lokale, veçanërisht Këshillat Lokale, përballeshin me sfida të vazhdueshme që lidhen me mungesën e standardizimit të procedurave, paqartësinë rreth kompensimit të kryetarëve të këshillave dhe mungesën e informacionit të strukturuar për përbërjen e tyre. Projekti i mbështetur nga National Endowment Democracy që filloi në vitin 2021, vazhdoi të adresojë këto dobësi strukturore përmes kombinimit të analizës ligjore, mjeteve praktike, dialogut institucional dhe përfshirjes së aktorëve lokalë. Kjo qasje synon të forcojë rolin e këshillave lokale si ura lidhëse midis qytetarëve dhe vendimmarrjes komunale, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.



ARRITJET KRYESORE

- Është avancuar dialogu institucional për harmonizimin e praktikave komunale për kompensimin e kryetarëve të Këshillave Lokale, përmes konsultimeve me MAPL, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ekspertë ligjorë.
- U hartua një draft-qarkore sqaruese me udhëzime praktike për komunat, duke përkthyer interpretimin ligjor në udhëzime praktike për komunat, megjithëse miratimi formal u shty për shkak të situatës politike.
- U organizuan një punëtori rajonale në Mitrovicë (27 pjesëmarrës) dhe një punëtori kombëtar në Prishtinë (35 përfaqësues), ku u prezantuan analiza ligjore, udhëzuesi dhe paketa standarde e dokumenteve për Këshillat Lokale.
- U mbajt një fokus-grup për dizajnimin e bazës kombëtare të të dhënave për Këshillat Lokale dhe u zhvillua teknikisht baza kombëtare e të dhënave për Këshillat Lokale, duke mundësuar identifikimin dhe kontaktin me përfaqësuesit lokalë.
- U forcuan partneritetet me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës për institucionalizimin e kësaj platforme dhe bashkëpunimet në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti.
- U vazhdua promovimi i KerkoQasje dhe u shpërnda paketa standarde e dokumenteve për të standardizuar procedurat e Këshillave Lokale.
- Projekti kontribuoi në zhvendosjen e debatit nga ndërgjegjësimi drejt zgjidhjeve konkrete administrative për funksionimin e këshillave lokale.
- Në fillim të vitit 2025 projekti u riplanifikua për shkak të ndërprerjes së fondeve amerikane dhe m u aprovua për zgjatje me kosto deri në shtator 2026.

PUNA NË VAZHDIM

- Avancimi i dialogut institucional për miratimin formal të qarkores sqaruese mbi kompensimin e kryetarëve të Këshillave Lokale.
- Lansimi publik i bazës kombëtare të të dhënave për Këshillat Lokale dhe integrimi i saj në platformat institucionale relevante.
- Organizimi i një sesioni teknik me përfaqësuesit e komunave në Kolegjin e Drejtorëve të Financave të Komunave, në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, për të diskutuar zbatimin praktik të rekomandimeve për kompensimin e kryetarëve të Këshillave Lokale.
- Organizimi i punëtorive për anëtarët e Kuvendeve Komunale dhe zyrtarët komunalë, me fokus në përdorimin e paketës së dokumenteve dhe në bashkëpunimin praktik me Këshillat Lokale.
- Vazhdimi i promovimit dhe përdorimit të paketës së dokumenteve standarde për të rritur transparencën dhe funksionalitetin e këshillave.
- Thellimi i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe komunale për të institucionalizuar mekanizmat e pjesëmarrjes dhe mbikëqyrjes qytetare.
- Shpërndarja e interpretimit për kompenzimin e Keshillave Lokale nga analiza ligjore dhe materialeve përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës, përfshirë publikimin e bazës së të dhënave në faqen e tyre.

4. Fuqizimi i Rrjetit dhe Funksionimi i Sekretariatit të Platforma Civikos

Puna e Sekretariatit dhe Qeverisja e Brendshme

Gjatë vitit 2025, Sekretariati i Platforma Civikos ka vazhduar të koordinojë aktivitetet e rrjetit dhe të mbështesë funksionimin institucional të organizatës përmes bashkëpunimit të ngushtë me Bordin dhe organizatat anëtare. Një moment i rëndësishëm ishte mbajtja e Kuvendit të Anëtarëve të Platforma Civikos, ku u miratuan raportet vjetore dhe u zgjodh Bordi i ri i organizatës. Gjatë vitit, Sekretariati ka organizuar dhe mbështetur takime të rregullta të Bordit, takime me institucione publike, donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë, si dhe ka kontribuar në promovimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin e shoqërisë civile dhe përfshirjen e saj në proceset e politikëbërjes. Viti u përmbyll me një arritje të rëndësishme për platformën dhe sektorin, përzgjedhjen e Platforma Civikos si Anëtar Kandidat për Zgjerim (Enlargment Candidate Member - ECM) në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (European Economic and Social Committee).



ARRITJET KRYESORE GJATË 2025

- Platforma Civikos vazhdoi të luajë rol kyç në informimin e anëtarësisë, duke shpërndarë 50 buletine informative dhe 21 njoftime specifike për mundësi financimi dhe angazhimi, duke forcuar komunikimin e vazhdueshëm dhe qasjen në mundësi për organizatat e shoqërisë civile.
- Më 25 prill 2025 u mbajt Kuvendi i Anëtarëve të Platforma Civikos në Pallatin e Rinisë në Prishtinë.
- U miratuan raportet vjetore të punës dhe u zgjodh Bordi i ri i organizatës. Bordi i ri përbëhet nga: Bujar Kadriu (Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar), Dren Puka (Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile - KCSF), Nermin Mahmuti (Fondi i Zhvillimit të Komunitetit - CDF), Qëndrim Hoxha (Shoqata e Zhvillimit të Liderimit - LDA Europe) dhe Shkumbin Arifi (SHL Kosova).
- Më 7 maj 2025 u mbajt takimi i parë i Bordit të ri, ku znj. Nermin Mahmuti u zgjodh Kryesuese e Bordit.
- Në të njëjtin takim, Dardan Kryeziu u emërua Drejtor Ekzekutiv i Platforma Civikos.
- Gjatë vitit u mbajtën 4 takime të rregullta të Bordit për drejtimin strategjik të organizatës.
- Në shtator 2025, Bordi vendosi të iniciojë procedurën për shkallëzimin e anëtarësisë në Platforma Civikos dhe përgatitjen e Kuvendit të radhës.
- U zhvilluan takime me institucione publike për të avancuar bashkëpunimin me shoqërinë civile, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë.
- Nëntor 2025, Platforma Civikos, së bashku me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, organizuan një takim me përfaqësues të Ambasadës së Holandës, ku u prezantuan rezultatet e projektit të përbashkët dhe u diskutua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për transparencë, mbrojtje të të dhënave dhe qeverisje të mirë.
- U prezantuan rezultatet e projekteve të përbashkëta në fushën e transparencës, mbrojtjes së të dhënave dhe qeverisjes së mirë.
- Sekretariati përgatiti dhe publikoi përmbledhje të gjetjeve kryesore nga [Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për shoqërinë civile në Kosovë](#).
- Platforma Civikos u përzgjedh si Anëtar Kandidat për Zgjerim (ECM) në kuadër të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (EESC), duke mundësuar për herë të parë përfaqësimin e drejtpërdrejtë të shoqërisë civile të Kosovës në dialogun dhe proceset këshilluese të Bashkimit Evropian.
- Dhjetor 2025, Platforma Civikos organizoi një takim me përfaqësues të Këshillit të Evropës, ku u diskutua roli i shoqërisë civile në Kosovë dhe mundësitë për bashkëpunim në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës dhe përfshirjes qytetare.
- Platforma Civikos mori pjesë në panel në Forumin e Shoqërisë Civile 2025 të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), duke kontribuar në diskutimet për qëndrueshmërinë e sektorit dhe bashkëpunimin me institucionet, donatorët dhe sektorin privat.

PUNA NË VAZHDIM

- Forcimi i mëtejshëm i rrjetit të organizatave anëtare dhe rritja e përfshirjes së tyre në aktivitetet e Platformës.
- Zbatimi i vendimeve të Bordit për reformimin dhe shkallëzimin e anëtarësisë së rrjetit.
- Hartimi i Strategjisë të Sekretariatit të Platforma Civikos Zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë për avancimin e rolit të shoqërisë civile në Kosovë.



European Economic and Social Committee
Comité économique et social européen
Europees Economisch en Sociaal Comité

www.eesc.europa.eu

Foto: Ndërtesa Jacques Delors në Bruksel, Belgjikë, e cila shërben si seli e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (EESC). | E disponueshme vetëm për përdorim editorial.

STORIE SUKSESI

ZËRI I SHOQËRISË CIVILE TË KOSOVËS NË TRYEZAT EVROPIANE

Në vitin 2025, një derë e re u hap për shoqërinë civile të Kosovës.

Platforma Civikos u përzgjedh si Anëtar Kandidat për Zgjerim (ECM) në kuadër të European Economic and Social Committee (EESC), një nga mekanizmat kryesorë për dialogun e shoqërisë civile në Bashkimin Evropian. Për herë të parë, zëri i organizatave të shoqërisë civile nga Kosova fitoi hapësirë të drejtpërdrejtë në diskutimet dhe opinionet që formësojnë politikat në nivel evropian.

Ky zhvillim nuk erdhi lehtë. Iniciativa për përfshirjen e vendeve të rajonit ishte nisur në vitin 2023 për shtetet kandidate për anëtarësim në BE, ndërsa Kosova fillimisht mbeti jashtë si anëtar formal. Përmes angazhimit të vazhdueshëm dhe advokimit për përfshirje të barabartë, u arrit që edhe shoqëria civile e Kosovës të bëhet pjesë e këtij mekanizmi.

Si një nga 15 organizatat përfaqësuese, Platforma Civikos tashmë kontribuon në diskutime evropiane, duke sjellë perspektivën e sektorit civil nga Kosova dhe duke forcuar lidhjen e tij me proceset integruese. Ky rol nuk është vetëm simbolik, pasi ai krijon mundësi reale për ndikim, shkëmbim përvojash dhe përgatitje për pjesëmarrje në strukturat e Bashkimit Evropian.

Ky moment shënon më shumë se një përfshirje institucionale. Ai përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një shoqërie civile më të fuqishme, më të lidhur dhe më të përfshirë në rrugën evropiane të Kosovës.

Ngjarjet dhe Publikimet

Gjatë vitit 2025, aktivitetet dhe projektet tona luajtën një rol përcaktues në fuqizimin e dialogut mes shoqërisë civile dhe institucioneve, duke e vendosur bashkëpunimin sektorial në qendër të agjendës zhvillimore në Kosovë.



NGJARJET TONA GJATË VITIT 2025

Shkurt 2025

- [Sesion informues](#) regional në Mitrovicë për të prezantuar pakon e dokumenteve mbi funksionimin e Këshillave Lokal;
- [Takimi i grupit punes për hartimin e Strategjisë Qeveritare](#) për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile;
- [Seria e trajnimeve mbi Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave Personale](#) për zyrtarët e institucioneve publike;

Prill 2025

- [Fokus Grupi mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale](#) në sektorin e OJQ-ve;
- [Takim konsultativ me organizata të shoqërisë civile](#) për prezantimin e Draft Strategjisë për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile 2025-2030;
- [Kuvendi i Anëtarëve](#) të Platforma Civikos;
- [Sesion informues](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Gjilan;

Maj 2025

- [Trajnim mbi Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave Personale](#) për zyrtarët e institucioneve publike;
- [Sesion informues në Pejë](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- [Sesion informues në Prizren](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Qershor 2025

- [Sesion informues në Mitrovicë](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- [Trajnim mbi Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave Personale](#) për zyrtarët e institucioneve publike;
- [Sesion informues regional](#) për të prezantuar pakon e dokumenteve mbi funksionimin e Këshillave Lokal;

Korrik 2025

- [Takim për forcimin e bashkëpunimit Qeveri – Shoqëri Civile;](#)
- [Sesion informues në Ferizaj](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- [Sesion informues në Prishtinë](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale;


Gusht 2025

- [Seria e trajnimeve për zyrtarët publikë](#) në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale;
- [Sesion informues në Gjakovë](#) mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale;


Shtator 2025

- [Konferenca përmbyllëse](#) “Fuqizimi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Sigurisë Kibernetike në të gjitha sektorët në Kosovë”;


PUBLIKIMET GJATË VITIT 2025



[Udhëzues për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane](#)



[Udhëzues për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për organizatat e shoqërisë civile](#)



[Analiza ligjore për bashkëfinancimin e OJQ-ve nga fondet e BE-së](#)

The background of the entire page is a blue-tinted photograph of a group of people in a meeting. They are gathered around a table, looking at documents and talking. Overlaid on this photograph is a white network diagram consisting of numerous small dots connected by thin lines, creating a web-like structure across the top and middle of the image.

www.civikos.net
info@civikos.net